



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 270/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Nenad Laziç dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP) me seli në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP) me seli në Prizren, për shkak të manipulimit me vota, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 11.06.2014. mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP) me seli në Prizren.

**Arsyetim**

Me datë 09.06.2014 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik KTAP ku pretendohet se në qytetin e Prizrenit, në Qendrat e Votimit QV 2004A/01R, 2004A/02R, 2004A/03R, 2004A/04R, 2004A/05R, 2004A/05R, 2004A/06R, 2004A/07R, 2004A/08R dhe 2004A/09D, përfaqësuesit e subjektit politik KDTP kanë tentuar të manipulojnë me procesin zgjedhor. Më tutje theksohet se në Komunën e Mamushës me rastin e emërimit të kryesuesve të Këshillave të Vendvotimit KVV procesi i manipulimit ka filluar që nga hapja e fushatës zgjedhore dhe ka vazhduar brenda institucionit të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëjë rinumërimin e kutive të votimit në QV 2004A/01R, 2004A/02R, 2004A/03R, 2004A/04R, 2004A/05R, 2004A/05R, 2004A/06R, 2004A/07R, 2004A/08R dhe 2004A/09D.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

**ankesa është e pabazuar**

Nga pretendimet ankimore të cekura, nuk mund të vërtetohet ajo për të cilin deklarohet pala ankuese në ankesën e saj, pasi që nuk është ofruar asnjë provë si dëshmi. Prandaj një pretendim i tillë ankimor është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu vërtetuar dhe se për këtë arsye ankesa në fjalë u vlerësua si e pa bazuar, sipas nenit 3.6 pika c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 270/2014 më datën 11.06.2014



**Udhëzim Juridik:**

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*